

AKT THEMELIMI

ISHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“Autocheck SHPK”

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “Autocheck SHPK”, është themeluar nga ortakët:

- **Z. Klodian Cali** lindur në Tiranë, më 25.01.1983, dhe banues në Njësinë Bashkiake Nr. 8, Rr. “4 Dëshmorët”, Nr. 116, Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit personal me *Nr. I30125065O*, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar;
- **Z. Luisa Keta** lindur në Tiranë, më 24.09.1989, dhe banues në Njësinë Bashkiake Nr. 2, Rr. “Mihal Grameno”, Nr. 51/2, Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit personal me *Nr. I95924065D*, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar;

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Shoqëria është person juridik i së drejtës shqiptare dhe gëzon të drejtat e personit juridik nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar dhe dispozitat e aktit të themelimit të këtij statuti.

Neni 1

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

Dhënie me qira të automjeteve, motoçikletave etj. Dhënie me qira tek të tretët të të gjitha llojeve të automjeteve, mjeteve motorike dhe jomotorrike. Shitje blerje të automjeteve, motoçikletave të reja dhe të përdorura, importin, eksportin dhe tregtimin me shumicë apo pakicë të të gjitha llojeve të mjeteve motorike duke përfshirë importin e auto veturave, mjeteve të transportit të pasagjerëve, mjeteve motorike dhe jomotorrike. Importin, eksportin, si dhe tregtimin me shumicë apo pakicë të pjesëve të këmbimit, aksesoreve, agregateve për të gjitha llojet e mjeteve motorike, duke përfshirë pjesët e këmbimit për të gjitha llojet e auto veturave, mjeteve motorike për transportin e pasagjerëve. Kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes dhe të riparimit (servisit) për të gjitha llojet e mjeteve motorike, duke përfshirë kryerjen e këtij shërbimi për auto veturat, mjetet e transportit të pasagjerëve. Ushtrimin e aktivitetit për parkim, lavash etj.

Neni 2

SELIA E SHOQËRISË

1. Shoqëria është person juridik privat.
2. Shoqëria do të paraqitet në qarkullim me emërtimin e saj **Autocheck SHPK**.
3. Selia e shoqërisë ndodhet në Tiranë në adresën: Rruga Shemsi Haka, Godina e ish Poligrafikut Nr1, Njesia Bashkiake nr.1

Neni 3

REGJIMI JURIDIK I SHOQERISE

Shoqëria udhëhiqet nga parimet e ekonomisë së tregut dhe ka për qëllim fitimin. Ajo respekton parimin e reciprocitetit. Ajo është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k.). Veprimtaria

e saj i nënshtrohet dispozitave të Aktit Themelimit, Statutit si dhe dispozitave të legjislacionit tregtar e atij civil në fuqi.

Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, shoqëria mundet që të ndryshojë regjimin juridik të saj në përputhje me dispozitat ligjore që do të jenë në fuqi si dhe në përputhje të plotë me dispozitat e Aktit të Themelimit dhe të Statutit të saj, duke bërë edhe përshtatjen e tyre sipas ndryshimeve përkatëse. Shoqëria gëzon personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar. Shoqëria do të këtë vulën e saj.

Neni 4 KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë do të jetë pa afat, me mundësinë e zgjatjes apo të shkurtimit të afateve, të ndryshojë veprimtarinë, emërtimin, selinë, objektin e veprimtarisë sipas vendimit të ortakeve të shoqërisë.

Neni 5 TRANSFERIMI I KUOTAVE

Ortakët e shoqërisë mund të kalojnë pjesën takuese të secilit prej tyre, nga kapitali themeltar, personave të tjerë në përputhje me rregullat e parashikuara në nenin 73 të ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Neni 6 PARAQITJA KONTABILE

Operacionet e shoqërisë kontabilizohen duke aplikuar parimet e kontabilitetit të parashikuara në legjislacionin shqiptar dhe paraqitjen me saktësi në bilancin vjetor të aktivitetit.

Në mbyllje të çdo viti ortakët ose personi i ngarkuar prej tyre, bën inventarizimin dhe llogaritë vjetore në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për kontabilitetin dhe harton raport me shkrim. Ky raport pasqyron gjendjen e shoqërisë gjatë vitit financiar.

Neni 7 KAPITALI THEMELTAR/

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga 2 (dy) kuota kontributi i ortakut themelues të kësaj shoqërie në para në vlerën 10.000 (dhjetemijë) lekë. Kuota e kapitalit themeltar të shoqërisë është e ndarë si më poshtë:

1. Z. Klodian Cali, në cilësinë e ortakut të shoqërisë zotëron 50% të vlerës së kuotës në kapitalin themeltar ose 1 (një) kuotë.
2. Z. Luisa Keta, në cilësinë e ortakut të shoqërisë, zotëron 50% të vlerës së kuotës në kapitalin themeltar ose 1 (një) kuotë.

Neni 8 OPERACIONET FINANCIARE/

Shoqëria është e autorizuar për të siguruar mjete financiare dhe kredit duke ju drejtuar bankave, institucioneve të kreditit ose atyre të financimeve totale apo të jashtme, institucioneve ndërkombëtare të financimit dhe të kreditit sido që të jetë përcaktuar.

Neni 9
BLERJET E SHOQËRIVE

Shoqëria disponon mjetet e saj në përputhje me destinacionin e tyre dhe me objektin e shoqërisë. Në territorin e Republikës së Shqipërisë, shoqëria gëzon të drejtën e saj për të zotëruar mjetet e saj si në çdo shoqëri tjetër ose organizatë tregtare, kombëtare shqiptare në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

Neni 10
FONDI REZERVË

Shoqëria mund të themelojë një fond rezervë si dhe fonde të tjera të veçanta për zhvillimin e tij.

Përbërja, shuma totale, fondet për krijimin e tyre përdorimi dhe rregullimi i tyre (i çdo fondi) përcaktohet nga ortakët në përputhje me legjislacionin shqiptar. Vlerat materiale të shoqërisë raportohen në bilance të shprehur në lekë shqiptarë, në përputhje me rregullat në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Bilanci dhe përlllogaritjet ekonomike të shoqërisë hartohen mbi bazën e formës së bilancit dhe llogaritjeve ekonomike të përcaktuara për shoqëritë tregtare në Shqipëri. Bilanci vjetor mbyllet në 31 Dhjetor të çdo viti.

Neni 11
PLANET FINANCIARE

Aktiviteti i shoqërisë mbi bazën e programeve financiare që bëjnë pjesë në aktivitetin financiar të saj. Planet financiare parashikojnë koston dhe të ardhurat e shprehura në lekë shqiptare. Gjendja pasurore dhe llogaritjet ekonomike do të paraqiten në lekë shqiptarë. Rezultatet financiare të aktivitetit dhe të punës së kryer nga shoqëria, paraqiten në bilancin vjetor. Kursi i këmbimit të monedhës shqiptare në monedhat e huaja dhe e kundërta do të jenë ato të vendosura nga Banka e Shtetit Shqiptar.

Neni 12
ORGANET E SHOQËRISË

Organi vendimmarrës i shoqërisë “Autocheck SHPK” është asambleja e ortakëve e përbërë nga ortakët e shoqërisë. Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- d) emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “d” të kësaj pike;
- f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat “e” dhe “h” të pikës 1 të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës. Të gjitha vendimet e marra nga ortaket e shoqërisë regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- d) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t’i kundërdrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 13

MBLEDHJA E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

Asambleja e Përgjithshme mbledhet në rastet e përcaktuara nga ligji 9901, datë 14.04.2008, nga ligje të tjera dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.

Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët apo ortakët e përcaktuar sipas nenit 84 të këtij ligji.

Asambleja e përgjithshme thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkuar brenda 3 muajve në vazhdim.

Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, pavarësisht vlerës së aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Në rastet e parashikuara në pikat 3 deri në 5 të këtij neni, asambleja e përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinë e administratorëve.

Neni 15

MËNYRA E THIRRJES

Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t’u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 16

KËRKESA NGA ORTAKËT E PAKICËS

Ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë, apo një pjesë më të vogël të parashikuar në statut, mund t’i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të

përmbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta ortakë kanë të drejtë ta thërrasin asamblenë dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës, në përputhje me pikën 1 të nenit 83 të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Nëse, në kundërshtim me pikën 1 të këtij neni, asambleja e përgjithshme nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë:

a) të ngrejë padi në gjykatë, për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse administratorët nuk përmbushin kërkesat e ortakëve brenda 15 ditëve;

b) t'i kërkojë shoqërisë blerjen e kuotave, të zotëruara prej tyre.

Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet, sipas parashikimeve të pikave 1 e 2 të këtij neni dhe thirrja i është njoftuar ortakëve, administratorët njoftojnë përsëri rendin e ditës, të ndryshuar, në përputhje me parashikimet e nenit 14 te statutit.

Përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar të deklarojë çdo fakt apo rrethanë, të tillë që, sipas gjykimit të ortakut të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendimmarrjen e përfaqësuesit për interesa të tjerë të ndryshëm nga ata të ortakut të përfaqësuar.

Neni 16

PËRFAQËSIMI NË ASAMBLE

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 17

KUORUMI

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 18

MARRJA E VENDIMEVE

Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë, asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, siç përcaktohet në pikën 1 të nenit 86 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj ose në statut, për çështjet e tjera të renditura në nenin 81 të ligjit për shoqëritë tregtare, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj, vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në këtë ligj ose në statut, kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.

Neni 19

PROCESVERBALET E MBLEDHJES SË ASAMBLESË

Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme.

Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.

Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.

Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

Nëse shoqëria ka publikuar një faqe në internet, administratorët, jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes, janë të detyruar të publikojnë kopje të procesverbalit të mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në këtë faqe.

Neni 20

ADMINISTRATORI

Asambleja e përgjithshme emëron një ose me shume persona fizike si administratore te shoqërisë. Afati i emërimit, nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Administratori i Shoqërisë “Autocheck SHPK”, do të jetë Z. **Klodian Cali** lindur në Tiranë, më 25.01.1983, dhe banues në Njësinë Bashkiake Nr. 8, Rr. “4 Dëshmorët”, Nr. 116, Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit personal me Nr. **I301250650**, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar;

Shoqëria do të përfaqësohet përpara çdo organi administrativ, gjyqësor, apo çdo entiteti tjetër publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretet nga Administratori i shoqërisë, i cili ushtron të drejtat e tij në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

Neni 21

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ADMINISTRATORIT

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

1. kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
2. përfaqësojë shoqërinë tregtare;
3. kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
4. përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, të paraqesë këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
5. krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
6. kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
7. raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
8. kryeje detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

9. të thërrasë asamblenë e përgjithshme kur shoqëria brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara dhe kur sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

Në rast se Asambleja e Përgjithshme cakton më shumë se një Administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë. Statuti ose rregulloret e tjera, të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme, mund të parashikojnë ndryshe.

Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 22

RASTET E PUNËS

Raportet e punës ndërmjet shoqërisë, filialeve dhe agjencive të saj si dhe të punonjësve në të, rregullohen në bazë të kontratës së punës, konform Kodit të Punës.

Për sa nuk parashikohet në kontratën e punës, aplikohen dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi.

Shoqëria merr përsipër, të shlyejë rregullisht të gjitha detyrimet e saj që burojnë nga legjislacioni për sigurimet shoqërore e shëndetësore lidhur me të punësuarit e saj.

Neni 23

PËRFUNDIMI I AKTIVITETIT

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar priset:

1. Me kalimin e afatit për kohëzgjatjen e saj në kontratën e themelimit.
2. Për pamundësinë e realizimit të objektit të saj.
3. Me vendimin e gjykatës.
4. Me hapjen e procedurave të falimentit.

Neni 24

LIKUIDIMI

Likuidimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar do të behet sipas normave të legjislacionit shqiptar në fuqi në kohën e likuidimit.

Neni 25

DISPOZITATE FUNDIT

Ky Statut hyn në fuqi pas miratimit dhe regjistrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Gjithçka nuk është parashikuar shprehimisht në këtë Statut do të disiplinohet nga legjislacioni tregtar dhe ligje të tjera të lidhura me të në fuqi në Republikën e Shqipërisë.


Ky Statut përpilohet në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe dhe u nënshkrua pa vërejtje nga ortakët themelues.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE
Autocheck SHPK

Z. Klodian Cali
Nënshkrimi



Z. Luisa Keta
Nënshkrimi



Dt 13.01.2022